

**PKR.nr.37/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit gjykues, anëtarëve të trupit gjykues-gjyqtaret Alltën Murseli dhe Shashivar Hoti, me bashkëpunorin profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.L., për shkak të veprës penale të ricilësuar Mashttrim nga neni 261 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda PP.I.nr.1225/2013 të datës 03.10.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Arian Gashi, i akuzuari Sh.L., me dt: 20.08.2018 mori dhe shpalli publikisht:

**A K T G J Y K I M**

**I AKUZUARI:**

**SH.L.**, nga i ati I., e ëma M., e vajzërisë A., i lindur më ..., në D., Me nr. personal; ... tani me vedbanim P., lagjën Q., rr.K.Z., pa nr., ka të kryer Fakultetin Ekonomik, me profesion ekonomist, a.1 i “m.”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 par.1 pika 3 të KPPRK-së

**LIROHET NGA AKUZA**

**SE:** gjatë muajit Qershor të vitit 2012 me anë të paraqitjes të rreme të fakteve, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për subjektin A. K., ( në të cilin subjekt i akuzuari ka kryer punët rreth kontabilitetit), ka vënë në lajthim ATK, në atë mënyrë që ka ofruar shërbimet e pagesave të dt; 15.06.2012 dhe 19.06.2012, të cilat pagesa i kishte bërë, pastaj anuluar në U. në P., pronar i së cilës ka qenë vet i akuzuari, se gjoja janë kryer obligimet tatimore për subjektin A.K., përfshirë edhe gjobat në vlerë prej 21.803.53 euro, me ç’rast ATK është vu në lajthim dhe ka zhbllokuar masat e ndërmarra nga mbledhja e detyshme me qëllim të inkasimit të borxhit tatimor të subjektit A. K.,-

- me çka kishte për të kryer veprën penale: Mashtrim nga neni 261 par.1 të KPK-së

Shpenzimet e procedurës penale mbeshin në barre të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate koform neni 454 par.1 të KPPRK-s.

Kërkesë pasuroro-juridike nuk pati

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritë aktakuzë PP.I.nr.1225/2013 të datës 03.10.2014, kundër të akuzuarit Sh.L. për shkak të veprës penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me aktgjykimin PKR. 525/14 të dt:03.10.2017 ka liruar nga akuza të akuzuarin Shkëlçim pasi që ka vlerësuar që nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i njëjti është kryerës i veprës penale për të cilën është akuzuar, mirëpo Gjykata e Apelit me aktvendimin PAKR nr 592/17 të dt: 06.02.2018 PAKR. ka vendosur prishjen e aktgjykimit dhe kthimin e çështjes në rivendosje për shkak të shkeljeve procedurale dhe mungesës së elaburimit të provave që mbeshesin dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësorë pas leximit të aktakuzës, me rastin e deklarimit të të akuzuarit lidhur me çështjen e fajësisë në kuptim të neni 326 par.1 të KPPRK-së, i akuzuari Sh.L. ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë, dhe duke qenë se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për aktakuzën në fjalë, gjykata duke u bazuar në neni 327 par.1 nënpar.1.2 të KPPRK –së, ka vendosë që seanca e shqyrtimit gjyqësorë të vazhdojë me prezentimin e provave.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, prokurori i shtetit Arian Gashi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga të gjitha provat e administruara është vërtetuar bindshëm fakti se i akuzuari Sh.L. ka kryer veprën penale “Mashtrim” nga neni 261 par.1 të KPK-së. Gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve V.K., R.G.dhe N.Gj.dhe se po ashtu edhe nga vet natyra kontradiktore e mbrojtës së të akuzuarit të paraqitur në deklaratat e dhënë në procedurën paraprake dhe mbrojtës së paraqitur në shqyrtim gjyqësor. Po ashtu ka shtuar se nuk duhet t’i falet besimi ekspertizës financiare Nr. 050/18 të dt:14.05.2018 pasi që e njëjta është zhvilluar për periudhën kohore e cila nuk ka qenë objekt i kësaj aktakuze. Andaj, ka propozuar që i akuzuari Sh.L. të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar të ATK-së Sh.G., ka deklaruar se nuk paraqesin kërkesë pasuroro-juridike, pasi që subjekti A.-K., sa i përket pagesës për periudhën 2012 obligimet janë kryer.

I akuzuari Sh.L. në mbrojtjen e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë mbrojtjes së paraqitur në shqyrtimin e mëparshëm e në të cilin kishte deklaruar se në vitin 2012 ka qenë a.2 i drejtorit gjeneral të R., ndërsa ka qenë edhe p. i U. si agjensionit për shërbime kontabëlitetit, ndërsa që nëna e tij ka punuar si arkëtare në këtë biznes, i cili është si lloj vetëpunësimi, ndërsa që A. K., ka qenë kompani në pronë të B.K. të cilin e ka pasur koleg në R. dhe nuk ka qenë i punësuar në të njëjtën dhe nuk ka

pasur kontratë pune e as autorizime, mirëpo i ka ndihmuar rreth procesimit të deklaratave dhe rregullimit të gjendjes në ATK, pasi që ka pas shumë probleme me periudha të ndryshme tatimore dhe në këtë drejtim me dt.19.06.2012 e ka thirrur ATK për t'i marr disa letërkujtesa të borxhit të A.-K., për marrjen e të cilave e ka dërgu mikun e tij F.M., ndërsa që nëna e të akuzuarit e cila atë ditë ka punuar si a.3 në W.U., në vend që ta bëj deklarinimin që ka bërë pagesë në sistemin softverin e pagesave të U., me të cilin program ata kanë punuar, mirëpo kjo pagesë automatikisht është anuluar nga U., pas 30-40 sekondave, për shkak se nuk është dasht të jetë pagesë, mirëpo vetëm deklarim i qarkullimit të tatimit dhe meqenëse vlera ka qenë mbi 10.000 euro, sipas rregullave të B., në rast se kemi pagesë mbi 10.000 euro, atëherë ajo duhet të shoqërohet me deklaratë nën betim, për prejardhjen e mjeteve, ndërsa që ai pasi që me datë 20 dhe 21 ka ranë ditë e shtunë dhe e diele, të hënë në mëngjes ka shkuar në ATK dhe e ka njoftuar për këtë gabim dhe poashtu i ka dorëzuar dokumente kopje të pagesave të bëra gabimisht ku ka qenë e shkruar Stornim dhe ATK e ka bërë një kopje, origjinalin e posedon ai. ATK e posedon kopjen e origjinalit që ja ka dorëzu ai, një inspektori tatimor, mbiemrin e ka pas G., të cilën e ka sqaruar edhe gojarisht lidhur me gabimin që është bërë, dhe se brenda asaj jave B.K. p. i A. ka paguar 70 përqindëshin e borxhit të A. në ATK, ndërsa 30 përqindëshi tjetër, është paguar në muajin gusht dhe shtator të vitit 2012, në shumë totale prej 22.000 euro, pasi që janë hequr profatura që gabimisht i janë ngarkuar, e për heqjen e të cilave edhe është angazhuar tani i akuzuari. Më tutje ka shtuar se llogaria e A.K. nuk ka qenë asnjëherë e bllokuar, dhe sa i përket bllokimit në dogana A.-K. nuk ka çertifikatë doganore dhe si e tillë nuk ka vlej as bllokimi as çbllokimi, sepse është firmë shërbyese dhe nuk eksporton as nuk importon mallra, andaj nuk ka pasur as bllokim as deblokim të mjeteve.

Ndërsa që kur është ballafaqur me deklarinimin në polici të dt.01.10.2012 se “pasi që A.-K. ka pas borxhe ndaj ATK në këtë rast i është blloku xhirollogaria bankare të këtij subjekti tani pas pagesës së borxhit a i është zhblloku llogaria” ka thekësuar se ka dallim në mes llogarisë dhe xhirollogarisë, dhe se fjalën e ka pasur për llogarinë e ATK-së dhe se e njëjta është çbllokuar pasi që në ATK ka dorëzuar raportin vjetor, është bërë zhbllokimi i llogarisë, me numër .... I akuzuari edhe në deklaratën që ka dhënë në procedurën paraprake, i është referuar të njëjtave rrethana, duke shpjeguar në mënyrë të ngjajshme paqartësit e krijuara lidhur me obligimet e paguara në raport me ATK-në, dhe se pse është krijuar një problem i tillë, duke filluar që me raportin e tij me A.K., pastaj gabimin e bërë nga nëna e tij dhe veprimin e ndërmarur nga vetë ai me rastin e dorëzimit të faturave të stonuara në ATK. Po ashtu i akuzuari edhe në fjalën përfundimtare të paraqitur në formë të shkruar ka përshkruar në mënyrë të ngjashme pretendimet e tij lidhur me faktin se nuk është kryerës i veprës penale për kryerjen e të cilës është akuzuar, ashtu që ka pohuar se ai asnjëherë nuk ka qenë në kompaninë A.-K. dhe as që ka pasur autorizime të kësaj natyre nga kjo kompani dhe i gjithë roli i tij ka konsistuar në ndihmën që i ka ofruar pronarit të A.-K. dhe një barre tatimore të ngarkuar atë kohë padrejtësisht nga ATK. Më tutje ka shtuar se edhe pse prokuroria me datë 15.06.2012 dhe me datë 19.06.2012 ka dërguar nëntë dëftesa të pagesave në vlerë prej 21.803.53 euro mirëpo nuk ka ofruar asnjë pagesë të datë 15.06.2012, përveq dëftesave të ofruara nga vetë ai të datë 19.06.2012, ndërsa që shtatë dëftesave tjera të përmendura në aktakuzë kësaj gjykate nuk I janë ofruar asnjëherë për arsye se të njëjtat nuk ekzistojnë, ndërsa që shuma e dy pagesave të anuluar nuk është 21.803.53 euro siq pretendon prokuroria, por është shuma prej 14.169.55 euro dhe pagesa në shumë prej 13.718.87 euro është bërë në ora 09:34 minuta ndërsa që është anuluar në mënyrë automatike nga operacionet e U. në ora

09:34:07 për shkak së sipas ligjit B. çdo pagesë mbi 10.000 euro duhet shoqërohet me betim mbi prejardhjen e mjeteve, ndërsa pagesa tjetër në shumë prej 450.68 euro është bërë në ora 09:36 minuta dhe është anuluar në ora 09:36:31 dhe që në këto të dy pagesa diferencë në mes printimit të pagesës dhe anulimit të të njëjtave është jo më shumë se 50 sekonda dhe se nuk ka pasur mundësi që në këtë periudhë kaq të shkurtë kohore me shku në ATK dhe me I ofru këto dëftesa si pagesa të bëra dhe prapë më u kthyer më qëllim që të njëjtat me I anuloi. Poashtu edhe pretendimi i prokurorisë se veprimet e të njëjtit janë bërë me qëllim të zhbllokimit të xhirollogarisë fare nuk qëndrojnë pasiqë xhirollogaria e A.-K. nuk ka qenë asnjëherë e bllokuar, dhe siç kanë thksuar të gjithë dëshmitarët pagesa e borxhit A.-K. në ATK është bërë në vitin 2012, mirëpo asnjëri nga të njëjtat nuk ka arritur të tregojnë se si është bërë kjo pagesë borxhi, ndërsa që të njëjtit e kanë pranuar faktin se tatimpaguesi bënë pagesën e tatimit dhe kjo pagesë nuk regjistrohet në sistemin e ATK-së dhe në rastin e A.-K. 70% e obligimit është kryer përmes pagesës direkte në qershor 2012, ndërsa pjesa prej 30% sipas marrëveshjes me ATK-në A.-K. e ka paguar përmes bankës ekonomike në shtator 2012. Më tutje ka shtuar se mosprocesimi i këtyre pagesave ka ardhur si pasojë e moskomunikimit në mes të departamentit të procesimit dhe departamentit të të hyrave në ATK, dhe siç ka theksuar edhe dëshmitarja V.K. raporti i sjellur nga m. I procesimit në ATK T.F. mund të jetë gabim dhe se pikërisht ky raport ka shërbyer si bazë për nisjen e hetimit kundër të njëjtit. Andaj, duke i'u referuar fakteve dhe provave të lartëcekura rrethanave që në periudhën prej 12 viteve ka punuar në institucione dhe kompani të ndryshme dhe asnjëherë nuk ka pasur asnjë vërejtje kundër të njëjtit, ka kërkuar që të shpallet I pafajshëm lidhur me veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata pas vlerësimit të provave të proceduar një ga një dhe të gjithave së bashku nuk ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit .

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat personale dhe materiale të propozuara nga palët në provcedurë, dhe atë dëshmit të dëshmitarëve R.G., T.F., N.Gj., V.K., nënëtkujtesat për pagesë tatimpaguesit, dy faturat-fletedeponimet e dt.19.06.2012, emaili përgjegjës të ATK-së të dt.19.06.2012, e-maili i dt.04.09.2012, email-i i dt.31.08.2012, emaili i dt.24.08.2012, dy faturat – fletedeponime të dt:19.06.2012, dy faturat – fletedeponime të dt:19.06.2012 vërtetohet se në të njëjtat është shkruar fjala stornim, gjendjen e përgjithshme të subjektit A.K. të shtypur nga zyrtarë të ATK me dt: 01.10.2012, ekspertizën financiare të dt: 14.05.2018 të ekspertit financiar V.I.

Është lexuar deklarata e dëshmitari R.G.e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt: 13.04.2107 në të cilën ka deklaruar se ATK lidhur me këtë rast është njoftuar nga mbledhja e detyrueshme e regjionit përkatës që gjatë verifikimit ka vërejtur se pagesat e paraqitura nga subjekti A.-K.në funksion të shlyerjes së obligimeve tatimore në vlerë prej rreth 20.000 euro nuk janë kryer, me ç'rast edhe kanë kërkuar nga zyra e standardeve profesionale që funksionon në kuadër të ATK-së të sqarohet se si ka ardhur deri te kjo situatë, për çka e njëjta pas hetimeve të kryera përmes një raporti i është drejtuar policisë së Kosovës të cilët kanë kryer veprime të mëtejme hetimore lidhur me këtë pagesë të pa realizuar. Më tutje dëshmitari ka sqaruar se ATK në vazhdimësi i njofton subjektet me përkujtesa për obligimet e tatimeve për pagesën e tatimeve të llojeve të ndryshme siç ka vepruar edhe me subjektin A.-K.dhe se kontabilisti i këtij subjekti në ATK ka paraqitur kopjet e pretenduara të këtyre pagesave dhe se me rastin e pranimit ATK ka bërë zhbllokimin e masave të mbledhjes së detyrueshme të tatimit, heqjen e bllokimit të

Ilogarisë bankare etj, dhe se në kohën për të cilën po bëhet fjalë ka qenë një sistem i tillë pagese ku subjekti i caktuar tatimpagues pasiqë ka pranuar përkujtesën e lartëcekur, ka bërë pagesën në një bankë e cila ka ndalur sa i kujtohet dëshmitarit dy kopje kurse një kopje e ka marrur tatimpaguesi, përmes së cilës është konfirmu së është kryer pagesa. Më tutje dëshmitari ka pohuar se sipas legjislacionit tatimor tatimpaguesi është i obligum me pagu shumën në tërësi apo të hyj në marrveshje me ATK për pagesën e shumës së tatimeve me këste, dhe në rastin konkret në bazë të shkresave të lëndës janë kry pagesa 21.000 euro në bazë të shkresave të lëndës, dhe nga përkujtesat që i ka pranuar në ATK nga A.K. këto mbajn datën e printuar në ATK 18.06.2012, kurse pagesa e cila pretendohet të jet kryer në U. mban datën 19.06.2012 një ditë pasë, ndërsa që pagesa reale e borxhit është bërë katër muaj me vonesë. Po ashtu dëshmitari ka deklaruar se ATK është mashtruar në këtë rast pasi që ATK-ja ju ka paraqit dëshmi për pagesa të detyrimeve tatimore e të cilat në fakt nuk kanë ndodh realisht, dhe mbi këtë bazë edhe i ka ndërmarr veprimet e zhbllokimit të masave të mbedhjes së detyrueshme për subjektin A.- K..

Është lexuar deklarata e dëshmitari dëshmitarit T.F. në dëshminë e dhëne në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt: 13.04.2017 , ka deklaruar se punon në cilësinë e menaxherit të divizionit të llogarive tatimore në ATK dhe se këtë pozitë e ka mbajtur edhe në vitin 2012, ndërsa që lidhur me zhbllokimin e masave nga mbledhja e detyrueshme për subjektin A.-K.ka deklaruar se nga zyrtarët e mbledhjes B.G. dhe V.K. përmes emalit i është kërkuar që t'i verifikoj pagesat lidhur me këtë subjekt, ndërsa që të njëjtëve i ka kthyer përgjigjien se nuk mund të bëhet procesimi për shkakun se të njëjtat mungojnë në raportin e pagesave ne B. dhe se një përgjigje të tillë u'a ka kthyer me datë 31.08.2012. Më tutje ka shtuar se në shkresa janë fletëpagesat në mes të cilave edhe fletëpagesa e datës 19.06.2012 mirëpo të njëjtat kanë munguar në raportin e pagesave të pranuar nga B. dhe se lidhur me subjektin A. ai posedon dy fletëdeponie për pagesë të datës 19.06.2012 në vlerë prej 13.719.87 euro dhe 41.169.55 euro dhe se vetëm këto i ka pranuar nga mbledhja e detyrueshme dhe për të cilat është kërkuar verifikimi dhe procesimi dhe se që nga korriku i viti 2010 të gjitha pagesat në sistemin e ATK-së barten në mënyre automatike pa intervenimin e dorës së njeriut e që fjala është për pagesat e pranuar nga bankat komerciale prej të cilave një numër shumë i vogël nuk mundën me u bartë automatikisht për arsyse të ndryshme teknike dhe se tatimi konsiderohet i paguar në momentin që pagesa raportohet nga banka qëndrore me ç'rast bankat komerciale për çdo pagesë të bërë i raportojne B. dhe e njëjta i bartë në ATK. Po ashtu dëshmitari pasi që është deklaruar se nuk është në dijeni se me dt.26.09.2012, në banka R.B. është bërë pagesa prej 4.418.87 euro nga A.K., i është ofruar në shikim raporti i dt.26.09.2012, që sipas dëshmitarit në këtë raport evidentohet se me dt. 26.09.2012 e kemi një pagesë në vlerë prej 4.448.87 euro, pagesa është bërë në R.B. për tatimin mbi vlerën e shtuar, për periudhën tatimore 2009 dhe se raporti kur është nxjerrë, kur është filtru e ka përfshi komplet periudhën një vjeqare të pagesave të bëra nga tatimagusi në fjalë, ky raport çdo herë mundët mu verifiku dhe përfshihen 10 pagesa në vlerë prej 12.702.09 euro. Dëshmitari në dëshminë e tij ka sqaruar edhe një rrethanë ku në bazë të raportit të B. rezulton se pagesa është bërë me datë 29.06.2012 ndërsa që gjatë dëshmisë nga i njëjti u prezantuan dy fletëdeponime të cilat mbajnë datën 19.06.2012, ku ka deklaruar se çdo dëshmi pagese e cila nuk është lajmëruar ne B. nuk është valide dhe se këtë dëshmi për pagesë e ka lëshuar U. që është institucion financiar dhe se subjektet afariste kanë pasur të drejtë të bëjnë pagesën edhe nëpërmjet këtyre institucioneve, mirëpo i njëjti nuk ka qenë në gjendje të sqarojë situatën se si është e mundur që përderisa të gjitha pagesat

barten në mënyrë elektronike në rastin konkret këto dy pagesa të mos figurojnë në listën e pagesës së tatimit nga subjekti afarist ne BQK.

Është lexuar deklarata e dëshmitarës N.Gj.e dhënë në seancat e shqyrtimit gjyqësor të dt: 13.04.2017 dhe 05.06.2017 ku ka deklaruar se është shefe e sektorit të pagesave në U., që është një subjekt i cili ka mar licencë për shërbim në bankë qendore për shërbim të arkëtim pagesave dhe se këtë, shërbim U. ua jep gjithë rrjetit të cilët janë subjekte private juridike të cilat punojnë në mënyrë të pavarur dhe nën përgjegjësinë e tyre, por në udhëzime që ka U., dhe se veprimet konkrete që kryhen në sistemin e pagesave dhe përgjegjësinë për kryerjen e veprimeve e kanë vet subjektet private , përfshirë edhe stonimin e një veprimi, I cili veprim nuk figuron në sistem dhe se perforimi I vulvae të U.-së është përgjegjësia e personit që kryen veprime. Më tutje dëshmitarja ka spjeguar veprimin e stonimit, duke deklaruar se U. posedonë një manual që të spjegon gjithçka që në momentin e paraqitjes së klientit, deri në momentin e dhënjës së urdhërpagesës, dhe e kanë aty të përcaktuar se si duhet të veprojnë për një pagesë dhe se stonimi si veprim bëhet brenda ditës, dhe mund të bëhet për shumë arsye, dhe se kur stonohet veprimi, gjëja e parë është se së pari shënohet “Stonim” dhe se si fletpagesa e rregullt, si fletpagesa e stonimit është dokumentacion i agjencisë dhe ato mbesin në agjenci dhe se në momentin që stonohet, ajo nuk konsiderohet si pagesë e rregullt në sistemin e tyre. Po ashtu ka shtuar se lidhur me dy veprime që janë të stonuara me dt.19.06.2012, sa i përket shumës prej 13.718.87, e njëjta është stonuar në ora 09:34:47,ndërsa që shuma prej 450.68 është stonuar në ora 09:36:31, këto stonime janë kryer nga operatori me shifër 473 dhe me kodin e agjencisë K134, kod ky i agjencis “F.k.” dhe se ky kod i përket Sh.L., ndërsa që këto stonime janë të regjistruara në sistem në raportin e stonimeve dhe ato janë të stonuara ne sistem, mirëpo lidhur me vulen ka thekësuar se nuk është kompetente me dhan përgjigje.

Është lexuar deklarata e dëshmitarës V.K. e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt: 05.06.2017, ku ka deklaruar se tani punon avokate e tatimpaguesve, ndërsa që më herët ka punuar project-menaxher i mbledhjes së detyrueshme, dhe lidhur me rastin konkret pagesat të cilat kanë ardhur si të dëshmuara në ATK pas një kohe kanë figuruar ende në listën e borgjlive që kanë qenë të evidentuara në sistem, andaj kjo ka qenë arsyeja që është inicuar rasti dhe është kërkuar verifikimi nga departamenti i procesimit në kuadër të ATK –së, me ç’rast ju është thënë se këto nuk janë pagesa reale, mirëpo që bazuar në këtë fletpagesë është bërë zhblllokimi i masave të vendosura mbi A.-K.dhe se obligimi tatimor për tu paguar ka qenë 21.262.81 euro , ndërsa që pagesat janë bërë me 15,16,18 dhe 19.06.2012 dhe kur janë mbledh gjitha këto, është bë deblllokimi, mirëpo nuk janë procedu në sistem sepse nuk kanë qenë reale, ndërsa që nuk e ka ditur nëse të gjitha fletëpagesat kanë qenë jo reale apo ndonjëra prej tyre, ndërsa që kur është pyetur nga tani i akuzuari se sipas një raporti të pagesave të kryera nga A.- K. për vitin 2012 të ofruar nga tani dëshmitari T.F.-M. i procesimit i ATK-ës, del se shuma është vetëm 7.628.22 për vitin 2012, ndërsa që dëshmitarja permend shumën prej 22.000, e njëjta është përgjigjur se “Ka mundësi me pas gabim, është dasht me pyet atë jo mua”. Po ashtu dëshmitarja ka pohuar se e-maili i dt. 31.08.2012 i dërguar nga T.F. sipas të cilës pagesat nuk janë kryer ka qenë bazë për fillimin e hetimeve, ndërsa që ka pasur edhe raste tjera që ka dal se nuk është pagesë reale, mirëpo në momentin kur e kanë përcjell në departamentin përgjegjës, është dëshmuar se pagesat janë reale pasi që ka qenë raporti i bankës, ndërsa që nëse paguhet në bankë duhet ta ketë edhe dëshmin e bankës vërtetimin e bankës në bazë të cilit është kryer pagesa që i bashkangjitet dokumentacionit dhe se

pagesat e dt. 19.06.2012 në vlerë prej 21.800.00 ka pas vërtetim të bankës, ndërsa që fletëpagesat për dt; 15.06.2012 dëshmitarja ka pohuar se nuk i posedon vërtetimin e bankës mirëpo ka mundësi të jenë në dosje të regjionit.

Nga 9 (nëntë) përkujtesat për pagesat e tatimpaguesit, vërtetohet se të njëjtat janë nënshkruar dhe vulosur nga subjekti financiar U.F.P.-U. e më të cilat dëshmohet se janë bërë pagesat e tatimit.

Nga dy faturat – fletëdeponime të dt:19.06.2012, konstatohet se subjekti tatim pagues A.K. me shifren 473 ka bërë pagesën në shumë prej 13,719.87 euro dhe po ashtu ka bërë pagesën në shumë prej 451.68 euro.

Nga dy faturat – fletëdeponime të dt:19.06.2012 vërtetohet se në të njëjtat është shkruar fjala stornim.

Nga e-maili i dt.04.09.2012 të emertuar si Shqetësim lidhur me pagesa të subjektit A. të dërguar nga V.K.-projekt menaxhere e DM, per A.S., konstatohet se subjekti A.K. ka pasur obligime ndaj ATK-së në vlerë prej 21,262.81 për çka edhe ka qenë i bllokuar në bankë, dogana dhe thesar, ndërsa që me datë 19.06.2012 i ka sjellë LK të paguara bashkë me raportet e pagesave, me ç'rast i është debllokuar, mirëpo që ka rezultuar që pagesa nuk është kryer, ashtu siq ka pretenduar subjekti A.K.. Ndërsa që nga email-i i dt.31.08.2012 konstatohet se tani dëshmitari T.F. i ka shkruar tani dëshmitarës V.K. duke konstatuar se edhe pse pagesat figurojnë në letër kujtesë për subjektin A.-K., të njëjtat nuk janë bërë. Ndërkaq që nga emaili i dt.24.08.2012 i dërguar nga B.G. për T.F. konstatohet se "në attachment kemi rastin kur tatimpaguesi A.-K.Sh.p.k 600518601 ka kryer pagesën e borxhit gjatë muajit Qershor 2012 (15,16,18 dhe 19.06.2012) kurse ende figuron borxhi i pashlyer.

Nga gjendjen e përgjithshme të subjektit A.-K. të shtypur nga zyrtarë të ATK me dt: 01.10.2012 vërtetohet se gjendja e llogaris se subjekti A.-K. nga viti 2005 deri në vitin 2012.

Nga eksepertiza financiare e dt:14.05.2018 e ekspertit financiar V.I. vërtetohet se në të njëjtën është dhënë mendimet dhe konstatimet si në vijim: subjekti "A.-K." shpk nuk ka obligime të papaguara për tatimet dhe ndëshkimet kontestuese; obligimet që kanë rrjedhur sipas përkujtesa për pagesat e vonuara për periudhën 2007, 2008, 2009, për këto periudha janë paguar prej dt:26.09.2012 dhe 15.20.2012. Subjekti ka pasur ndëshkime për mosmbajtje të librave apo evidencave sipas ligjit për këto periudha të njëjtat janë paguar me dt: 01.10.2012. U. ka natyrë të punës pagesa me para të gatshme, kryen transfere në bazë të dokumenteve për pagesë, nuk ka llogari të hapur për subjekte andaj kryen vetëm transferta.

Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë në të cilën u administruan të gjitha provat materiale, të njëjtat i vlerësoi veç e veç dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, gjykata ka vlerësuar se nuk është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshmin e dëshmitarit R.G. mirëpo të njëjtës ja fali pjesërisht besimin dhe atë vetëm lidhur me pjesën e sqarimeve lidhur me rrjedhshmërinë e veprimeve të kryera nga ATK lidhur me subjektin A.-K., rrethana këto që as që kanë qenë kontestuese, mirëpo gjykata vlerëson se konstatimet e dëshmitarit se ATK është mashtruar nga A.K., janë në kundërshtim me provat materiale të administruara në këtë

çështje penale, por edhe dëshmitë e dëshmitarve tjerë, e po ashtu edhe me vetë deklaratimet e këtij dëshmitari të dhëna në procedurë paraparake, gjegjësisht në deklaratën e dhënë në prokurori me dt. 02.05.2014, në të cilën deklaratat se subjekti A.-K., ka falsifikuar dokumentet e bankës në bashkëpunim me tani të akuzuarin Sh.L., ndërsa që shqyrtimi gjyqësor nuk ka përmendur falsifikimin, mirëpo është mjaftuar më mashtrimin, ani pse në të dy rastet, janë konstatime paushalle, të pambështetura në ndonjë provë, por që këto konstatime ulin besueshmërinë e dëshmisë së këtij dëshmitari, i cili në mungesë të çfarëdo rrethane, i ka lejuar vetës të bëjë konstatime të kësaj natyre, që dëshmohen edhe pohime tjera të bërë në deklaratë të dhënë në prokurori me datë si më lartë, ku ka pretenduar të shpjegoj qëllime e veprime të subjektit A.-K., ani pse pozita që ka pasur prej zyrtari ligjorë, nuk i ka mundësuar e as lejuar që të ketë interperetime të tilla të pambështetura në prova.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit T.F. dëshmi të cilën gjithashtu e ka vlerësuar si dëshmi objektive, të sinqertë dhe nga e cila vërtetohet i pakontestueshëm fakti se lidhur me subjektin ARC janë vetëm dy fletëdeponime për pagesë të datës 19.06.2012 dhe se vetëm këto i ka pranuar nga mbledhja e detyrueshme dhe për të cilat është kërkuar verifikimi. Po ashtu nga ky dëshmitar vërtetohet pakontestueshme fakti se tatimi konsiderohet i paguar në momentin kur pagesa e bërë në bankën komerciale raportohet në BQK, e cila pastaj raportohet në AKT, dhe se në raportin e BQK-së nuk janë evidentuar pagesat e pretenduara, dhe se në mungesë të këtij raportimi nuk mundet me u quajë pagesa valide, ndërsa që çdo pages raportohet në mënyrë automatike nga B. në ATK.

Gjykata e ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarës N.Gj. nga e cila ka gjetur si dëshmi të sinqertë dhe objektive e përmes të cilës vërtetohet se fletëpagesat e dt.19.06.2012 në shumë prej 13.718.87 dhe 450.68 janë stonuar, gjegjësisht anuluar në po të njëjten datë përkatësisht në ora 09:34:4 dhe në ora 09:36:31, nga operatori me shifër 473 dhe me kodin e agjencisë ..., kod ky i agjencisë "F.k." dhe që siq vërtetohet nga e administruar në cilësi e provës materiale ky kod i përket Sh.L., duke rrëzuar kështu pretendimin e organit të akuzës se ky ishte një veprim i qëllimshëm, dhe në funksion të përfitimit të kundërligjshëm nga ana e të akuzuarit Sh.L..

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarës V.K. dëshmi të cilën e ka vlerësuar si dëshmi objektive dhe të sinqert, e nga e cila vërtetohet fakti se në ATK janë dorëzuar vetëm fletëpagesat me dt.19.06.2012 në vlerë prej 21.800.00, dhe se po ashtu nga kjo dëshmitare është vërtetuar fakti se ka pasur edhe raste tjera kur edhe pse është bërë pagesa, të njëjtat nuk janë proces në sistem.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe dy faturat – fletëdeponime të dt:19.06.2012, në të cilat është evidentuar fjala të stonuara, duke vërtetuar kështu faktin e pretenduar nga tani i akuzuari se vërtetë dy faturat e lartcekura janë dorëzuar në ATK dhe në të njëjtat është shënuar fjala të stonuara, si rrjedhojë e gabimit të nënës së të njëjtit M.L., ku në vënd që të shtyp opsionin e deklaramit, është shtypur opsioni i pagesës, dhe se i akuzuari në momentin e parë ka shkuar në ATK- ku ka dorëzuar fletëpagesat dhe ka njoftuar zyrtarin e ATK-së që ka arritur të ja mbaj mend mbiemrin G., të cilën e ka sqaruar edhe gojarisht lidhur me gabimin që është bërë. Po ashtu nga këto fletedeponime vërtetohet fakti se të njëjtat kanë të bëjnë me dt.19.06.2012, dhe se gjykata nuk ka administruar asnjë provë se nga tani i akuzuari Sh.L. është dorëzuar fletëdeponim i dt.15.06.2012 po ashtu vërtetohet



shumë e këtyre dy pagesave të anuluar, nuk është 21.803.53 euro siq pretendon prokuroria, por është 14.169.55 euro.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe 9 (nëntë) perkujtesat për pagesat e tatimpaguesit që i janë bërë A.-K., që i perkasin datave të ndryshme, dhe po ashtu gjendjen e pergjithshme të subjektit A.-K. të shtypur nga zyrtarë të ATK me dt: 01.10.2012 por përmes të cilave nuk vërtetohet ndonje fakt relevant lidhur me vepren penale për kryerjen e te cilës akuzohet i akuzuari Sh.L..

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe mendimin e ekspertit financiar V.I. të dhënë në ekspertizën financiare të dt: 14.05.2018, dhe të njëjtës ia ka falur besimin meqenëse konstatimet e bëra në të njëjtën janë të mbështetura në të dhëna të mjaftueshme dhe i shoqëruar me një elaborim të thelluar të premisave mbi të cilat janë mbështetur këto përfundime e nga të cilat vërtetohet se subjekti "A.- K." sh.p.k. nuk ka obligime të papaguara për tatimet dhe ndëshkimet kontestuese pas dt:15.10.2012 dhe të njëjtat janë paguar në periudhën kohore prej dt: 26.09.2012 deri më 15.10.2012

Gjykata po ashtu ka vlerësuar e-mailin e dt.04.09.2012, dt. 31.08.2012 dhe dt. 24.08.2012, përmes të cilave vërtetohet komunikimi në mes zyrtareve të ATK-së lidhur shqetësimet e ngritura lidhur me pagesat e tatimit nga A.-K.Sh.p.k, ndërsa që konstatohet se është bërë deblokimi i llogarive bankare të A.K., dhe po ashtu se A.-K. ka paraqitur fletedeponime të datë 15.16 dhe 18.06.2012, mirëpo gjykata të njëjtave nuk ua fali besimin pasi që siq është provuar nga dëshmia e dëshmitarit T.F., për tu konsideruar një pages valide, është e nevojshme raportimi nga B. në ATK, dhe se në rastin konkret një raport i tillë nuk ekziston, e po ashtu sipas dëshmitarit R.G.për të ardhur deri të zhbllokimi i llogarive është e nevojshme pagimi i shumës totale ose hyrje në marrëveshje me ATK-në, gjë që në rastin konkret nuk ka ndodhur asnjëra. E po ashtu, gjykata nuk ka administruar fletedeponime të datave të lartcekuar siq janë të referuara në emailin e dt.24.08.2012, përveq dy deponimeve të dt.19.06.2012.

Me provat e nxjerrura, është vërtetuar se i akuzuari Sh.L. nuk ka kryer veprën penale të Mashtrimit nga neni 261 par.1 të KPK-së, dhe se mbrojtja e të njëjtit është logjike, dhe në përputhje të plotë më provat e administruara në këtë çështje penale, dhe se i njëjti nuk e ka mohuar faktin se si pasojë e gabimit të bërë nga nëna e tij kur në vend që ta shtypte opsionin e" deklaramit" e ka shtypur atë të" pagesës", mirëpo i njëjti pasi e ka kuptuar këtë gabim ka ndërmarrur veprimet e nevojshme në anulimin e këtyre fletedeponimeve, siq vërtetohen edhe nga fjala "stornim" e shkruar në të njëjtat, ndërsa fakti që nuk e ka lajmëruar bankën B. lidhur më këtë, është arsyeja se sipas U. nuk guxon me ba pagesë mbi 10.000 euro pasi që çdo pagesë mbi këtë shumë sipas rregullave të BQK duhet të shoqërohet me deklaratë, po ashtu siq është pohuar edhe nga dëshmitari T.F.1, nuk quhet pages valide, asnje lloj pagesa e cila nuk është konfirmuar nga BQK-ja.

Po ashtu gjykata e ka gjetur të drejtë mbrojtjen e të akuzuarit se ai nuk ka ofruar kurrë shërbimet e pagesave të dt; 15.06.2012 siq është pretenduar nga organi i akuzës, pasi që gjykata nuk ka administruar asnjë provë për ekzistencën e fletedeponimeve të kësaj date, ndërsa që nga fletedeponimet e dt.19.06.2012, shuma del të jetë 14.169.55 euro dhe jo 21.803.53 euro. Po ashtu gjykata ka miratuar mbrojtjen e të akuzuarit Shkëlçim lidhur me zhbllokimin e masave të ndërmarra nga mbledhje e detyrueshme, pasi që organi i akuzës nuk ka arritur të vërtetojë se në cilën formë ka përfituar tani i akuzuari Sh., edhe përkundrejt faktit se i njëjti kishte marrur të gjitha veprimet e nevojshme për ta vënë në

djeni ATK-në, për gabimin e bërë, përçka edhe i kishte dorëzuar fletëdeponimin e stornuar dhe i kishte njoftuar gojarisht, lidhur me këtë. Në funksion të kësaj për t'u gjendur në kushtet e konsumimit të kësaj veprë penale duhet të ekzistojë qëllimi për t'i sjellë vetes apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore, e duke mashtruar ose e sjell personin tjetër në lajthim me anë të paraqitjes së rreme apo duke i fshehur faktet dhe në këtë mënyrë ta shtyt personin e tillë që të veprojë apo të mosveprojë në dëm të pasurisë së tij ose të pasurisë së ndonjë personi tjetër. Në këtë çështje penale lidhur me të akuzuarin Sh.L. nuk jemi në përmbushje të këtyre kushteve, pasi që siq është vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtiumit gjyqësor, pasi që e ka kuptuar për gabimin që është bërë nga nëna tij, ka shkuar në ATK dhe ka paraqitur fletëdeponimet e stornuara, duke i njoftuar njëherit edhe gojarisht për gabimin e bërë, duke e bërë kështu të paqenë ekzistencën e qëllimit për të i sjell vetës apo tjetrit përfitim të kundërligjshëm përmes sjelljes apo mbajtja në lajthim.

Meqenëse nuk është provuar se i akuzuari Sh.L. ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 261 par. 1 të KPK –së, gjykata konform nenit 364 parag 1 pika 1.3 të KPPRK-së e ka liruar ka aktakuza.

Në bazë të nenit 454 parag 1 të KPPRK-së është vendosë që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore.

Nga se u tha më lart është vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr.37/18, të dt:20.08.2018**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,**  
**Shadije Gërguri**

**Bashkëpunatori profesional,**  
**Driton Berisha**

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.